

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	GJKKO jep 50 vite burg për Durim Bamin dhe të tjerët, "i forti i Niklës" ia hedh me më pak vite nga sa kër koi SPAK, shpallet i pafajshëm për dy akuza (E PLOTË)
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/gjkko-jep-vendimin-per-durim-bamin-i-forti-i-nikles-ia-he-dh-me-me-pak-i401232
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:54:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:36:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8f534707384e9566ce4a1cb322878bc627f88b34e1c694f5ccc53bf779147963
TEKSTI	d82d2b2708067341daef257f7272456278b2649e731a301ad467638f79569403
PAMJA	0cb8e98ae871be25f594c5fb1e67c1ad7cce4874f2353307708a57d0c6a0d377

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b9515423be1e94c0a1c704369c54b29042411f321663baa4cc6ca2902dcbf19a
E MËPARSHMJA	656041528087ea5c7aef7a2bea2be19abc50e3bfc84f7b1c01f95af75f05051
RRËNJA MERKLE	9887a58f034e5892caf63e36cbe81dcf86c1b224001923b84c66783530d965e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b9515423be1e94c0a1c704369c54b29042411f321663baa4cc6ca2902dcbf19a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Aktualitet

15 Shtator 2026, 09:36

GJKKO jep 50 vite burg për Durim Bamin dhe të tjerët, "i forti i Niklës" ia hedh me më pak vite nga sa kërkoi SPAK, shpallet i pafajshëm për dy akuza (E PLOTË)

Shkruar nga Newsbomb



Aldo Avdyli-Altin Morina-Durim Bami dhe Henrigert Mitri

Tre muaj pas pretendës së kërkuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, GJKKO ka vendosur të shpallë vendimin këtë të martë sa i përket një prej fraksioneve të "Revanshit", dosje në të cilën bën pjesë Durim Bami dhe gjashtë persona të tjerë.

Burime për mediat konfirmojnë se ndryshe nga sa SPAK kishte kërkuar për të "fortin e Niklës", Durim Bami do të vuajë 10.8 vite burg sa i përket kësaj dosje. Vendimi është dhënë po ashtu edhe për pjesëtarët e tjerë, mes tyre dhe Aldo Avdyli, Henerigert Mitri dhe ish-eftektivin, Altin Morina.

Sa i përket Durim Bami GJKKO e ka shpallur fajtor për sigurimin e kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e një vrasjeje, kultivimin e bimëve narkotike si dhe krijimin dhe drejtimin e një grupi të strukturuar kriminal. Ndërkohë për dy raste të tjera, ku akuzohej për sigurimin e kushteve për kryerjen e vrasjes, gjykata e ka shpallur të pafajshëm.

Oltion Zefi është dënuar me 10 vite burg. Ai akuzohet për trafikim të narkotikëve dhe organizim të grupit të strukturuar kriminal. Gjykata ka vendosur që dënimin ta vuajë në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë, ndërsa masa do të

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

Dy nënkryetarë të rinj në Bashkinë e Benet Becit, njëri prej tyre kryetari i PS-së në Shkodër, kryebashkiaku i prezanton para ekipit drejtues



Bota

Gjykata Supreme i jep goditje Trump, bllokohet plani për kufizimin e votimit me postë

Zbulu më shumë artikuj >

ekzekutohet pas arrestimit të tij.

Edson Jozwik, i njohur edhe me emrat Edson Pjetri dhe Edmir Pjetri, është dënuar me 8 vite burgim. Ai është shpallur fajtor për trafikim të narkotikëve dhe pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal.

Për Altin Morinën, gjykata ka caktuar dënimin me 6 vite e 8 muaj burgim. Morina është shpallur fajtor për kultivim të bimëve narkotike, pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal dhe mbajtje pa leje të armëve. Për akuzën e mbajtjes së municioneve luftarake, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes.

Ndërkohë, Henerigert Mitri është dënuar me 5 vite e 4 muaj burgim. Krahas akuzave për kultivim të bimëve narkotike dhe pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, Mitri është shpallur fajtor edhe për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Me nga 4 vite e 8 muaj burgim janë dënuar Jozi Kraja dhe Aldo Avdyli, i njohur edhe me aliasin Elidon Avdyli. Të dy janë shpallur fajtorë për sigurimin e kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e një vrasjeje si dhe për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal.

SPAK kërkoj për Aldo Avdylin: 10 vite burg, 6.8 me gjykim të shkurtuar-**GJKKO** e dënoi me 4 vite e 8 muaj burg

SPAK kërkoj për Edson Jozwik: 15 vite burg, 10 vite me gjykim të shkurtuar-**GJKKO** e dënoi me 4 vite burg

SPAK këroi për Oltion Zefin: 20 vite burg, 13.4 vite me gjykim të shkurtuar-**GJKKO** e dënoi me 10 vite burg

SPAK kërkoj për Henerigert Mitrin: 9 vite burg, 6 vite burg me gjykim të shkurtuar-**GJKKO** e dënoi me 5 vite e 4 muaj burg

SPAK kërkoj për Altin Morinan: 13.6 vite burg, 9 vite me gjykim të shkurtuar-**GJKKO** e dënoi me 6 vite e 8 muaj burg

SPAK kërkoj për Jozi Krajan: 10 vite burg, 6.8 me gjykim të shkurtuar-**GJKKO** e dënoi me 4 vite e 8 muaj burg

SPAK kërkoj për Durim Bamin: 21 vite burg, 14 vite me gjykim të shkurtuar-**GJKKO** e dënoi me 10 vite e 8 muaj burg

Kujtojmë se dosja "Revanshi" konsiderohet një nga hetimet më të rëndësishme të SPAK-ut, pasi përfshin një sërë episodesh dhe persona të dyshuar për përfshirje në veprimtari të rënda kriminale, mes tyre vrasje, rrëmbime dhe planifikim atentatesh.

Në të përfshihen 12 ngjarje kriminale të cilat kanë ndodhur, janë përgatitur ose kanë mbetur në tentativë gjatë vitit 2020. Hetimi ka zbardhur aktivitetin e 7 grupeve kriminale në qytete të ndryshme të vendit, mes tyre Lezhë, Durrës, Krujë, Tiranë, Vlorë dhe Burrel.

Pjesë e këtyre 7 grupeve kriminale, veç njerëzve të botës së krimit, u evidentuan dhe emra zyrtarësh policorë, si ish-drejtori i Policisë së Lezhës, Henerigert Mitri apo dhe politikanë si ish-deputeti socialist, Arben Ndoka, e vëllai i deputetit Eduard Ndreca, Armando Ndreca.

Në maj të vitit 2024, me urdhër të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ranë në pranga 20 persona, 14 prej tyre në Shqipëri dhe 6 të tjerë jashtë vendit, 2 në Itali, 1 në Gjermani, 1 në Spanjë dhe 2 në Belgjikë.

Ky megaoperacion aso kohe erdhi pas zbërthimit të komunikimeve në aplikacionet sekrete "Sky" dhe "EncroChat".

Falë zbërthimit të këtyre bisedave u bë i mundur edhe zbulimi i aleancave dhe planeve sekrete të grupit të Ervis Martnajt, i cili në aleancë me grupin e drejtuar nga ish-deputeti socialist, Arben Ndoka rekrutimin vrasës me pagesë të cilët vepronin kryesisht në zonën e Fushë-Krujës dhe në zonën e Burrelit.

SPAK kërkoj për ish-deputetin socialist dhe kryetar të grupit të krimit të organizuar të

SPAK për më tej se ish-deputeti socialist drejtonte një grup të riqasurim kriminal në zonën e Lezhës dhe kishte lidhur aleancë me Ervis Martinaj për vrasje të fortin e Nikës, Durim Bamin dhe Fatmir Hysenin, i konsideruar një ndër vrasësit më të rrezikshëm me pagesë nga Vlorë dhe i njohur me nofkën "Doqja".

"Në qendër të këtyre grupeve kriminale është grupi kriminal i krijuar dhe drejtuar nga shtetasi Ervis Martinaj, i cili është në aleancë me grupin kriminal që vepron në qytetin e Lezhës të drejtuar nga shtetasi Arben Ndoka. Këta dy grupe kriminale, për arritjen e qëllimit kriminal kanë kontaktuar anëtarë të një grupi tjetër kriminal i cili vepron në qytetin e Durrësit.

Gjithashtu, të dy këto grupe kriminale kanë rekrutuar vrasës me pagesë të cilët veprojnë kryesisht në zonën e Fushë – Krujës dhe në zonën e Burrelit. Po kështu për të realizuar qëllimet kriminale Ervis Martinaj, kontakton shtetasin Viktor Imerin, i cili sapo kishte përfunduar vuajtjen e dënimit me burgim i kërkon vrasjen e shtetasit Fatmir Hyseni.

Në ndihmë të grupeve kriminale të drejtuara Ervis Martinaj dhe Arben Ndoka, vijnë edhe shtetasit Emiljano Shullazi dhe A.Avdyl, të cilët edhe pse në kushtet e paraburgimit ndihmojnë Ervis Martinaj dhe Arben Ndokën, në realizimin e qëllimit kriminal që është vrasja e Durim Bami, etj.

Emiljano Shullazi kontakton me të hetuarin Tesilvan Basho, të cilit i kërkon vrasjen e Durim Bami. Po kështu Emiljano Shullazi, siguron informacione për lëvizjet e Durim Bami dhe këto informacione i'a vë në dispozicion shtetasit Arben Ndoka", thuhej në komunikatën zyrtare të Prokurorisë së Posaçme.

Ndërkohë, organi i akuzës zbardhi dhe aktivitetin kriminal të grupit të Niklës, që drejtohej pikërisht nga Durim Bami dhe pas lidhjes së aleancës me "Klanin Duka", u interesua veçanërisht për eliminimin e Ervis Martinaj, Arben Ndokës dhe njerëzve të tyre.

"Nga ana tjetër në zonën e Fushë Krujës spikat grupi kriminal i drejtuar nga shtetasi Durim Bami, i cili shfaqet në konflikt të hapur me grupet kriminale të drejtuara nga shtetasit Ervis Martinaj dhe Arben Ndoka.

Grup kriminal i drejtuar nga Durim Bami, bën aleancë me një grup kundërshtar të shtetasit Ervis Martinaj, dhe që drejtohet nga shtetasit Leonard Duka dhe Fatmir Hyseni, persona me precedentë të theksuar kriminal me qëllim vrasjen e Ervis Martinaj dhe Arben Ndoka, dhe anëtarëve të tjerë të këtyre grupeve kriminale", thuhej në njoftimin zyrtar të SPAK.

Ndërkohë sa i përket ish-Policit të Qarkut të Lezhës, u njoftua se ai drejtonte aktivitetin kriminal të kultivimit të narkotikëve në Lezhë sepse ishte kryepolic i qarkut, si dhe në bashkëpunim me shtetasin e skeduar për disa ngjarje kriminale Preng Gjini, lejonte lojërat e fatit.

Në kuadër të këtij megaoperacioni u sekuestruan pasuri me vlerë mbi 4.5 milion euro, përfshirë para cash, ora të shtrenjta, makinat të blinduara dhe florinj.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Martë 09:46

Emërohet Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së, ja kush është juristi që merr detyrën



Aktualitet

Rama publikon pamje nga transformimi i rrugës së Komanit: Një peizazh spektakolar i veriut shqiptar



Aktualitet

Sot vendoset fati për Veliqin, Gjykata e Lartë rishqyrton masën e sigurisë

E Martë 08:30

E Martë 08:56



E Martë 08:10

Ishte vjedhur disa kohë më parë në Panaja, gjendet e djegur fuoristrada në një tunel të vjetër ushtarak në Cerkovinë të Vlorës



Aktualitet

Kthjellime, vranësira dhe reshje shiu, parashikimi i motit për këtë të martë


E Martë 06:58



Aktualitet

Incidenti pranë shkollës në Tiranë, Balla: Sorrat të mos guxojnë të shkelin perimetritin e sigurisë

E Hënë 23:45





🕒 E Hënë 22:39

Akuzohet për drogën në trëndafila, “i tmerrshmi i Beratit” reagon me video

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.